

FORMULAR PËLQIMI PËR PËRDORIMIN E KONTRIBUTIT NË KOMUNIKIME

Këtu në Barnardo's ne mbështesim disa nga fëmijët më të cenueshëm në tërë MB përmes shërbimeve tona bazike, fushatave dhe hulumtimeve, ju falemnderit për ndihmën tuaj. Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me këtë formular ose si ta plotësoni, ju lutem flisni me kontaktin tuaj në Barnardo's p.sh. punonjës in e projektit ose kontaktin tuaj në ekipin e marketingut. Ata janë të gatshëm t'ju ndihmojnë dhe do t'ju ofrojnë rastin të shtroni pyetjet që keni.

Barnardo's ofron një gamë të burimeve të komunikimit për t'u treguar njerëzve lidhur me punën që ne bëjmë, për shërbimet tona dhe për të mbledhur para për punën tonë. Gjatë komunikimit tonë ne pëlqejmë të ndajmë përvojat e njerëzve të vërtetë të cilët shfrytëzojnë shërbimet tona meqë kjo na ndihmon të demonstrojmë ndryshimin që ne bëjmë përmes punës sonë. Duke plotësuar këtë formular, ju jepni pëlqimin që ne të përdorim çdo informacion që ju ofroni; të gjitha këtyre ne u referohemi si "**kontribut**".

Në rastet kur jepni kontribut, do t'ju jepet një kartë me detajet se si të na kontaktoni nëse doni të diskutoni ndonjë aspekt të kontributit tuaj apo të tërhiqni pëlqimin (nëse kështu vendosni më vonë).

Detajet e fëmijës/ personit të ri/ të rriturit që ofron kontributin:

Emri dhe mbiemri			
Adresa			
		Kodi postal	
Nr. i telefonit			
Email			

Për çfarë do të përdoret kontributi im? (Ju lutem vendosni tikun për opsionet me të cilat pajtoheni)

Prezantimet: Për personat që punojnë brenda dhe jashtë Barnardo's

Uebfaqet: Uebfaqja dhe intraneti (uebfaqja e punonjësve tonë) i Barnardo's

Rrjetet sociale: Faqet e rrjeteve sociale të Barnardo's dhe reklamat në rrjetet sociale që mund të përfshijnë: pod cast-in e Barnardo's, Facebook, Twitter, LinkedIn, Instagram, Pinterest, YouTube, Vimeo dhe Snapchat

Publikimet: fletëpalosje, raporte, postera, buletine dhe materiale të tjera reklamuese dhe marketingu të Barnardo's

Printime dhe media online: Kombëtare (në tërë MB), gazeta rajonale dhe lokale; revista dhe faqe lajmesh

TV dhe radio: TV shtetërore dhe rajonale; radio shtetërore, rajonale dhe lokale

Apele për mbledhjen e fondeve: postë direkte, email-e dhe postime në rrjete sociale për të ndihmuar mbledhjen e fondeve për punën e Barnardo's

Kontributi i ofruar nga ju do të:

- ruhet dhe përdoret për një periudhë kohore prej tre viteve, pos nëse vendosni ta tërhiqni pëlqimin;
- përdoret për të promovuar ose reklamuar qëllimet e Barnardo's përmes kanaleve që ne përdorim dhe që ju keni aprovuar;
- mbahen të sigurt dhe do të ndahen vetëm me furnizuesit tonë ose partnerët me të cilët punojmë për të ofruar dhe përmirësuar shërbimet; dhe
- (gjithashtu mund) t'u vihen në dispozicion për përdorim anëtarëve të ekipeve profesionale dhe të shërbimeve të Barnardo's ose mbledhësve tonë të fondeve.

Pëlqimi juaj mund të ndryshohet dhe tërhiqet në çdo kohë duke njoftuar Barnardo's me shkrim. Në rastin kur jepni kontributin, do t'ju jepet një kartë me detajet se si të tërhiqni pëlqimin, nëse vendosni të bëni një gjë të tillë më vonë. Megjithatë, duhet të jeni në dijeni se, në momentin kur informacionet lidhur me kontributin tuaj vendosen në internet, ne humbasim një shkallë të kontrollit mbi shpërndarjen, rikthimin dhe/ose heqjen e informacioneve. Kjo do të thotë se edhe nëse ne ndalojmë së përdoruri këto informacione

ekziston mundësia që të njëjtat të vazhdojnë të jenë në dispozicion në internet. Gjithashtu, ne nuk kemi kontroll mbi llojin e komenteve që mund t'i nënshtrohet kontributi juaj nëpër rrjetet sociale. Ju lutem të keni këtë parasysh kur të jepni pëlqimin tuaj më lart.

Në asnjë rast nuk do të shesim dhe/ose ndajmë detajet tuaja me palët e treta pos nëse kjo kërkohet me ligj nga Barnardo's ose nëse ekziston rrezik nga shkaktimi i dëmit.

Çdo herë që dëshirojmë të përdorim kontributin tuaj ne do t'ju kontaktojmë në mënyrë që të vërtetojmë se jeni të pajtimit të bëjmë një gjë të tillë. Gjithashtu, do t'ua shpjegojmë se për çfarë do ta përdorim. Këtë do ta bëjmë për t'u siguruar se kontributi juaj është i saktë dhe se ju ndiheni mirë që kjo të bëhet.

A mund të qëndroj anonim?

Ju mund të përzgjedhni që të publikohet emri juaj i vërtetë ose të qëndroni anonim (në këtë rast ne do të përdorim një emër të rremë). Ju lutem përzgjedhni njërin nga opsionet duke vendosur tikun:

Mund të përdoret emri im i vërtetë Nuk dua të përdoret emri im i vërtetë

A ka ndonjë karakteristikë identifikuese që NUK DONI të përfshihet në komunikimet tona? Për shembull, *vendndodhja juaj ose mosha juaj ose e fëmijëve tuaj* _____

Informacione shtesë

Arsyeja se pse shtrojmë këto pyetje është për t'u siguruar se kemi një shumëllojshmëri të njerëzve në tërë përmbajtjen e Barnardo's. Ju lutem shkruani në hapësirën më poshtë ose vendosni tikun në 'preferoj mos ta shpalos'. **Këto informacione janë vetëm për qëllime të brendshme.**

Mosha _____ Preferoj mos ta shpalos

Etnia _____ Preferoj mos ta shpalos

Gjinia _____ Preferoj mos ta shpalos

Jam i gatshëm të jap pëlqimin tim

Ju lutem firmosni këtë formular duke pranuar se jeni i gatshëm të jepni pëlqimin që kontributi juaj të përdoret nga Barnardo's për qëllimet e paraqitura më lart. Informacionet lidhur me kontributin tuaj nuk do të përdoren ose ruhen për më shumë se tre vite, pos nëse ju kërkoni që ne të ndalojmë përdorimin e tyre më përpara.

Firma Data

Nëse jeni nën moshën 18 vjeç, nevojitet pëlqimi me shkrim i prindit, kujdestarit ose i të rriturit përgjegjës.

Firma e prindit/
kujdestarit Data

Ju lutem dërgoni formularin e plotësuar punonjësit përgjegjës për çështjen ose kontaktit në Barnardo's, ose mund ta dërgoni me email në consentforms@barnardos.org.uk. Ju falemnderit.

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me formularin, ju lutem kontaktoni punëtorin përgjegjës për çështjen ose kontaktin në Barnardo's.

Mbrojtja e të dhënave: Barnardo's vlerëson mbështetjen tuaj dhe premtun se do të respektojë privatësinë tuaj. Të dhënat që ne mbledhim dhe mbajmë menaxhohen në pajtim me GDPR/Rregullorja mbi Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme/ dhe Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave të vitit 2018. Ne nuk do të shpalosim apo ndajmë informacione personale të dhëna nga ana juaj pa pëlqimin tuaj, pos nëse kjo kërkohet me ligj ose nëse ne besojmë se ekziston rrezik nga shkaktimi i dëmit. Njoftimin tonë të plotë mbi privatësinë mund ta shihni këtu: www.barnardos.org.uk/privacy-notice